



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 608 Prot.

Shkodër më 25.09 2025

### V E N D I M

Nr. 21, datë 24.09.2025

#### PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI  
SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË  
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RRIJTJEN E KAPACITETEVE TE QEVERISJES  
VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES  
VENDORE TË SHQIPËRISË (TALGA)**

Në mbështetje të nenit 2, pika 11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.6, shkronja "b", nenit 14 pika 5, neni 51 pika 4, nenit 77 shkronja "ç", "d", "gj", nenit 78 pika 1, nenit 83 shkronja "d", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 "Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, Këshilli të Qarkut Shkodër në mbledhjen e datës 24.09.2025, me prezencën e 16 anëtarëve të tij, me 16 vota Pro, asnjë kundër;

#### V E N D O S I:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, dhe anëtarësimin e Qarkut Shkodër në SKP, të quajtur "Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA)", bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi.